


RAPORT


I VLERËSIMIT TË JASHTËM, PËR PROGRAMIN E STUDIMIT PROFESIONAL DY VJEÇAR NË “TEKNOLOGJI NDËRTIMI” NË KOLEGJIN PROFESIONAL TË TIRANËS

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

PhD Egla Luca



PhD Erion Luga



Janar, 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Studimit profesional dy vjeçar në "Teknologji ndërtimi"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Profesional I Tiranës
2	Departamenti që e ofron	Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara
3	Urdhëri/VKM i licencimit Vendimi i Këshillit të Akreditimit	VKM Nr. 699, datë 26.08.2015 VKA Nr. 65, datë 30.06.2015
4	Titulli i programit të studimit:	Program studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në "Teknologji ndërtimi"
5	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Ofrohet vetëm nga Institucioni
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 5
15	Aktivizimi i programit të studimit	2017-2018
16	Numri total i studentëve për program studimi	9 studentë



HYRJE

Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) është licensuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 699, datë 26/08/2015 “Për licencimin e institucionit të arsimit të lartë, privat, me statusin e kolegjit profesional, “Kolegji Profesional i Tiranës”, Tiranë” si institucion i arsimit të lartë, privat, me statusin kolegji profesional – Kolegji Profesional i Tiranës, dhe ofron programe të studimeve jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në këto drejtime: *Teknologji informacioni dhe komunikimi; Elektronikë; Database dhe Web Design; Teknologji e Instalimeve Elektrike; Elektro-Mekanikë; Teknologji Automjetesh; Mekatronikë; Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi; Gjeodezi; Teknologji Ndërtimi, Administrim Zyre dhe Teknologji Gazi.* KPT si institucion i arsimit të lartë me orientim profesional, synon të përgatisë profesionistë me aftësi praktike dhe studentët diplomohen me titullin “Teknik i Lartë”.

KPT është pajisur me lejen e fillimit të aktivitetit sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 426, datë 06/11/2015 “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë institucioni të arsimit të lartë privat Kolegji Profesional i Tiranës, Tiranë.

KPT është Akredituar Institucionalisht me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 66 datë 21.09.2017, i vlefshëm deri më 30.09.2022.

Kolegji Profesional i Tiranës, ka të përcaktuara qartë në Statutin e tij, miratuar me Urdhër të MASR Nr. 147, datë 27.03.2018, Vizionin, Misionin dhe Objektivat e tij si institucion i arsimit të lartë me veprimtari të orientuar në formimin profesional të studentëve.

KPT përbëhet nga dy departamente:

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara.

Departamenti Teknologjisë së Informacionit ofron programet dyvjeçare si mëposhtë:

1. Teknologji informacioni dhe komunikimi
2. Elektronikë
3. Database dhe Web design
4. Teknologji e instalimeve elektrike
5. Administrim Zyre

Departamenti i Elektro – Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ofron programet dyvjeçare si mëposhtë:

1. Elektro – mekanikë
2. Teknologji automjetesh
3. Mekatronik
4. Teknologji ajrimi dhe kondicionimi
5. Gjeodezi
6. Teknologji ndërtimi
7. Teknologji Gazi

Programi i studimit “Teknologji ndërtimi”, kalon për herë të parë në këtë proces vlerësimi në kuadër të akreditimit. Ky program është hapur me Vendim të KM Nr. 699, datë 26.08.2015, pas një vlerësimi në kuadër të hapjes, realizuar me ekspertë të jashtëm nga ASCAL dhe vlerësim përfundimtar **Pozitiv**, i finalizuar me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 65, datë 30.06.2015.

Programi i studimit është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2017-2018, me 12 studentë të regjistruar.

I gjithë vlerësimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), sipas rubrikave të mëposhtme, është mbështetur në Dosjen e Vetëvlerësimit të hartuar dhe të dorëzuar nga Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) në ASCAL, në vizitën dy ditore të realizuar në ambientet e KPT, si dhe në dokumentacionin plotësues të kërkuar nga GVJ gjatë vizitës.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. PhD. Egla Luca.
2. PhD. Erion Luga

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Emisa Isufaj, Sektori i Statistikave dhe Analizave, ASCAL.

Kolegji Profesional i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.01.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 23 Prot, datë 14.01.2019. KPT përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 13/1 Prot, date 21.01.2019 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me rekomandimin (Komenti 1) Megjithatë një studim tregu i dokumentuar në formë anketimi që do të përfshinte një numër më të gjerë specialistësh dhe palësh të interesuara do të rriste efikasitetin e këtij programi, aspekt që reflektohet në vonesën e hapjes së programit, gjithashtu dhe në ndryshimet e kurrikulës gjatë periudhës midis licencimit dhe implementimit.

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim. Duke qenë se komenti është bërë në lidhje me planinin mësimor fillestar GVJ e konsideron të reflektuar dhe nuk ndryshon RVJ.

2. Lidhur me rekomandimin pjesa aplikative; si ajo e praktikës profesionale dhe ajo e punëve të laboratorit (veçanërisht në lëndët karakterizuese, të kategorisë B) duhet të zënë më shumë peshë respektivisht në kurrikul dhe në silabuse.

Vihet re nevoja për rritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit si nga aspekti sasior ashtu dhe nga ai cilësor (marrëveshje me laboratorë që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit).

Rekomandime\sugjerime:

Rekomandohet rritja e peshës së praktikës profesionale në kurrikulën e programit si dhe ajo e punëve të laboratorit në silabuset e lëndëve (veçanërisht në lëndët karakterizuese, të kategorisë B).

Rekomandohet rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me laboratorë që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit.

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzionit të formuluar në draft raport, duke theksuar dhe njëherë mungesën e laboratorëve në lidhje me fushat specifike apo të marrëveshjeve të formalizuara me laboratorë që mund të plotësojnë këto mangësi. RVJ nuk ndryshon.

3. Lidhur me konstatimin (Komenti 3) “Stafi administrativ punon për të gjithë institucionin. Ai përbehej nga sekretarja e përgjithshme, dy sekretare mësimore nga një për secilin departament, një për zyrën e karrierës, një e zyrës së personelit akademik, administratori dhe një financë, pra gjithsej 7 persona.”,

reflektohen ndryshimet në RVJ si më poshtë:

“Stafi administrativ punon për të gjithë institucionin. Ai përbehej nga Sekretarja e Përgjithshme Mësimore, dy sekretare mësimore nga një për secilin departament, Përgjegjësja e Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, Përgjegjësja e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Administratori, Financieri, Përgjegjësi dhe Specialisti i Zyrës

së IT, Përgjegjësi i Bibliotekës dhe Zyrës së Fotokopjes, 2 persona si dhe Mirëmbajtës i IAL, pra gjithsej 12 persona.”

4. Lidhur me rekomandimin (Komenti 4) Megjithëse sylabuset e lëndëve përfshijnë kredite të dedikuara për praktikë dhe punë laborator, vlen për tu theksuar mungesa e laboratorëve specifikë të fushës së teknologjisë së ndërtimit pranë institucioni apo marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë që operojnë në treg në fushën e teknologjisë së ndërtimit

Rekomandime/Sugjerime

Rekomandohet që sa më shpejt të jetë e mundur të ngrihen laboratorë specifikë në shërbim të programit të “Teknologjisë së ndërtimit”. Minimalisht studentët duhet të kenë mundësi të zhvillojnë disa prova bazike në lidhje me vetitë fizike dhe mekanike të materialeve të ndërtimit.

Komeneti i GVJ është i ngjashëm me komentin 2. Edhe në lidhje me këtë pikë, GVJ vlerëson punën e kryer deri tani nga institucioni, por asnjë nga laboratorët që paraqiten në RVB dhe në komentin e KTP nuk është në shërbim të lëndëve specifike të kategorisë B. GVJ i qëndron rekomandimit të formuluar në draft raport, dhe nuk ndryshon RVJ.

5. Lidhur me konstatimin (Komenti 5), “KPT shpk ka dy vite që ushtron aktivitetin e saj.”, **reflektohen ndryshimet në RVJ si më poshtë:**
“KPT ushtron veprimtarinë e saj që prej vitit 2015.”
6. Lidhur me rekomandimin (Komenti 6) “Nga kurrikula vihet re që kjo ndarje është e njëjtë për të gjitha lëndët. Kjo është paksa e vështirë pasi jo të gjitha lëndët kanë të njëjtën nevojë për leksione seminare etj. Sugjerohet të shikohet më me vëmendje shpërndarja e orëve”

GVJ inkurajon përpjekjet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit, por nuk ndryshon RVJ.

7. Lidhur me rekomandimin (Komentin 7) “Per kurrikulën e vitit akademik 17-18 vihet re që lëndë me zgjedhje është “Menaxhim i punimeve në kantier”. Kjo është një lëndë mjaft e rëndësishme për këtë program studimi ndaj rekomandohet që mos të jetë nën kategorinë me zgjedhje por të jetë nën kategorinë karakterizuese”.

Në lidhje me komentin Nr. 7” GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzionit të formuluar në draft raport me arsyetimin se lënda në fjalë është mjaft e rëndësishme dhe ajo duhet të jetë pjesë e lëndëve karakterizuese. IAL argumenton që kjo lëndë kryehet si pjesë e lëndëve të tjera, por GVJ gjykon se studenti ka nevojë për njohuri paraprake lidhur me menaxhimin e kantierit përpara se të shkoj në vend. RVJ nuk ndryshon.

8. Lidhur me rekomandimin (Komentin 8) “Një element që u mungon sylabuseve janë edhe format e mësimdhënies dhe metodologjia e ndjekur për ti arritur ato. Sygjerohet të shtohet ky element në sylabuset e ardhshme”.

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzionit të formuluar në draft raport dhe inkurajon përpjekjet në kuadër të përmirësimit të cilesisë së programit. RVJ nuk ndryshon.

9. Lidhur me rekomandimin (Komentin 8) “Në këtë program studimi rekomandohet angazhim i më shumë pedagogëve me kohë të plotë pasi ngarkesa akademike e disa pedagogëve është shumë e lartë për këtë program studimi”.

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzionit të formuluar në draft raport me arsyetimin që stafi akademik me kohë të plotë është mjaft i ngarkuar në nivel orësh. GVJ është në djeni të faktit që profesionistët në fushën e ndërtimit janë pa grada dhe tituj dhe ata preferojnë praktikën përpara botës akademike, megjithatë fakti që grada më e lartë për të dhënë mësim në një kolegji profesional është MSc, ky fakt do të lehtësonte ndjeshëm mundësinë për të thithur staf të ri akademik. RVJ nuk ndryshon.

10. Lidhur me rekomandimin (Komentin 10) “Sygjerohet që lëndët që kanë kredite që nuk plotëpjestohen me 3 te ritet apo ulet numri i krediteve që të kthehet në këtë formë”,

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzionit të formuluar në draft raport me arsyetimin që bërja e të gjitha lëndëve me kredite të plotë pjestueshme me 3 lehtëson ndjeshëm procesin e transferimit. GVJ është në djeni të faktit që këto lëndë janë të pakta prandaj IAL nuk do të ketë shumë vështirësi në ndyshimin e këtyre krediteve. RVJ nuk ndryshon.

11. Lidhur me rekomandimin (Komentin 11)

- a) Rekomandohet rritja e peshës së praktikës profesionale në kurrikulën e duke qënë se praktika zë vetëm 21 ECTS brënda programit të studimit
- b) Rekomandohet përfshirja e këtij programi studimi në projektet Erasmus+ ose të ngjashme me to
- c) Rekomandohet ulja e numrit të lëndëve dhe rritja e peshës së lëndëve karakterizuese. Vihet re që programi ka 21 lëndë në total (19 lëndë plus praktika dhe provimi final).
- d) Rekomandohet që vlerësimi final të kryhet nëpërmjet një projekti aplikativ dhe jo nëpërmjet një provimi final. Duke parë karakterin praktik dhe profesional të programit ky provim nuk i shkon për shtat profilit.

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzioneve të formuluar në draft raport me arsyetimin:

- a) **Duke qënë një shkollë me karakter profesional praktika duhet të zër peshën me të madhe të orëve dhe të krediteve. Praktika duhet të kryhet pranë një kantieri ndërtimi që në fillim të procesit deri në fund.**
- b) **Ashtu sic IAL e ka formuluar që projektet akoma nuk i kanë dhënë frytet, GVJ konstaton që programi specifik i studimit për momentin nuk është i përfshirë në asnjë projekt ndërkombëtar. Duhet theksuar fakti që programet profesionale janë shumë atraktive për thithjen e fondeve Erasmus+ CBHE.**

- c) IAL argumenton që, që nga momenti i licencimit nuk ka ndryshuar numri i lëndëve por fakti është që numri i krediteve ka ndryshuar (janë 28 kredite të ndryshuara që nga licencimi). GVJ konstaton që programi i studimit ka shumë lëndë në brëndësinë e vet. Një pjesë e konsiderueshme e tyre është teorike. GVJ rekomandon që të ulet numri i lëndëve teorike dhe orët e mbetura të zëvendësohen me praktikë gjatë vitit. Instituconi nuk duhet të limitohet vetëm me praktikën finale e cila ka 10ECT, IAL duhet të nxis praktika gjatë gjithë vitit.
- d) GVJ inkurajon përpjekjet në kuadër të përmirësimit të cilesisë së programit duke qënë se IAL është shprehur që në vitet në vijim do ta marrë në konsideratë këtë rekomandim
RVJ nuk ndryshon.

12. Lidhur me rekomandimin (Komentin 12) “Këtu shihet që praktika profesionale ka më pak orë nga të gjithë komponentët. Gjithashtu shihet që leksionet dhe labororet kanë orë të krahasueshme. Si një program profesional duhet ritur numri i orëve të praktikës profesionale dhe i laboreteve dhe të ulet nr i leksioneve teorike”,

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzionit të formuluar në draft raport me arsyetimin se ushtrimet sado karakter aplikativ të kenë ato kryhen brënda auditorit dhe nuk mund të konsiderohen si praktikë. Gjithashtu lidhur me labororet, nga vizita në IAL u pa që labororet e mirëfillta inxhinierike mungojnë brënda institucionit. Për rrjedhojë për të kryer labororet për lëndët specifike në disa raste IAL ka shfrytëzuar labororet jashtë instiucionit. Kjo nuk mund të bëhet për cdo herë, e për rrjedhojë edhe orët e laboreteve nuk mund të konsiderohen praktikë profesionale. Orët teorike janë të shumta brënda programit të studimit, GVJ rekomandon që ato duhen ulur që ti dhënë më shume hapsirë praktikës profesionale dhe laboreteve të mirëfillta lidhur me ndërtimin. RVJ nuk ndryshon.

13. Lidhur me rekomandimin (Komentin 13) “Forma e kontrollit të njohurive është e unifikuar për të gjitha lëndët. Rekomandohet që lëndë të ndryshme të kenë shpërndarje të ndryshme të komponentëve të vleresimit pasi çdo lëndë ka dinamikat e veta brënda saj”,

GVJ inkurajon përpjekjet në kuadër të përmirësimit të cilesisë së programit, por nuk ndryshon RVJ.

14. Lidhur me rekomandimin (Komentin 14) “Rekomandohet shtimi i titujve në gjuhën shqipe”,
GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzioneve të formuluar në draft raport me arsyetimin se literatura është një element kyc në formimin e teknikëve të rinj. Nëse kjo literaturë shoqërohet edhe me praktikë më të shumtë atëherë ky brez studentësh do të jetë më i miri në treg në fushën përkatëse. RVJ nuk ndryshon.

15. Lidhur me rekomandimin (komentin 15) “ Rekomandohet të hartohet një procedurë për rastin e gabimeve në regjistrat e notave dhe sygjerohet vënëmdje më e madhe në hedhjen e notave në regjistër”,

GVJ inkurajon përpjekjet në kuadër të përmirësimit të cilesisë së programit, por nuk ndryshon RVJ.

16. Lidhur me rekomandimin (Komentin 16) “Metodat e mësimdhënies nuk janë të paraqitura në sylabuset e lëndëve. Nga vizita në IAL na u tha që mësimi organizohet në format klasike të tij: Leksione, ushtrime dhe praktikë. Sygjerohet që të rritet numri i orëve jashtë auditorit për këtë program studimi.”,

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzioneve të formuluar në draft raport me arsyetimin se: jo cdo lëndë ka nevojë të njëjtë për orë jashtë auditori. Shpërndarja që bën IAL për orët e leksioneve, ushtrimeve dhe laboreve është e njëjtë. GVJ rekomandon që orët jashtë auditorit të konsiderohen pjesë e praktikës. RVJ nuk ndryshon.

17. Lidhur me rekomandimin (komentin 17) “Rekomandohet të rritet vizibiliteti i KPT në mediat sociale dhe jo vetëm në mënyrë që kjo shkollë të jetë sa më atraktive për të rinjtë që duan të ndjekin një arsim profesional. Rekomandohet që për vitet e para deri sa shkolla të krijojë themele të forta të përdoren politika favorizuese gjinore, për shtresat në nevojë dhe për ata me mesatare mbi 6.”,

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron konkluzioneve të formuluar në draft raport me arsyetimin se fakti që këtë vit akademik nuk ka patur asnjë student të regjistruar tegon që këto politika nuk kanë funksionuar. Fakti që ka shumë shkolla të ngjashme të licencuara duhet të shihet me pozitivitet dhe të nxis politikat e përthithjes së studentëve nga ana e IAL. Në mënyrë që kjo shkollë të ketë sukses mbi të gjitha duhet të ketë student. RVJ nuk ndryshon.

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Programi i studimit jouniversitar dy vjeçar “Teknologji ndërtimi”, ka si qëllim kryesor të përgatisë profesionistë me aftësi praktike si dhe të hedhë bazat teknike dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si Teknik i Lartë në fushën e teknologjisë së ndërtimit. Mbështetur në Raportin e vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe nga vizita në institucion. Qëllime të tjera të këtij programi studimi janë të ndihmojë studentëve në rritjen e kualifikimit dhe aftësive profesionale, trainimin profesional të tyre në mënyrë që ato të integrohen sa më shpejtë në tregun e punës, si dhe të sigurojë një bazë të mjaftueshme njohurish për të bërë të mundur transferimin e studentëve në programet e studimeve universitare etj.

Sipas Rregullores së programit të studimit, disa nga objektivat kryesore të tij janë: përgatitja e specialistëve të mirëfilltë në fushën e ndërtimit, si pjesë përbërëse e zinxhirit projektues të ndërtesave me funksione të ndryshme, të pajisë studentim me njohuri për të lexuar dhe analizuar projektet e specialistëve përkatës e për t'i implementuar ato në vepër, me njohuri të teknologjive më të përdorshme të ndërtimit, të vetive e materialeve të ndërtimit dhe mënyrën e vendosjes së tyre, mundësi për të hyrë në tregun e punës në fushën e aplikimit të projekteve arkitektonike, veprave inxhinierike, ndërtimit të rrugëve, mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit të objekteve ndërtimore të tipologjive të ndryshme, etj.

Prioritetet strategjike të Institucionit për të përmbushur objektivat e vëna dhe për programin e studimit në “Teknologji ndërtimi” dhe të pasqyruara në Strategjia e Institucionit, janë orientimi gjithnjë e më shumë drejt praktikës profesionale, ofrimi i një personeli akademik sa më cilësor ku të jenë kombinuar aftësitë teorike me ato praktike të tyre, krijimi i një infrastrukture sa më të mirë në mbështetje të procesit mësimor, bashkëpunimi me bizneset dhe Institucionet e tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, krijimi i mundësive për mësimin gjatë gjithë jetës.

Plani mësimor përfshin lëndë të formimit të përgjithshëm dhe plotësues, si; matematikë, fizikë, gjuhë e huaj dhe hyrje në teknologjinë e informacionit, si dhe lëndë specifike duke u përqëndruar në lëndët e teknologjisë së ndërtimit, materialeve të ndërtimit, mekanikës strukturale, mekanikës së dherave e themeleve, etj, me forma të mësimdhënies të kombinuara në leksione, ushtrime dhe punë laboratorike. Leksionet dhe ushtrimet janë shumë të rëndësishme për formimin teorik të studentëve ndërsa laboratorët për aplikimin praktikë të njohurive të marra në teori. Lënda e praktikës profesionale zhvillohet gjatë Semstrit II, të Vitit të dytë të studimeve.

Për vitin akademik 2017 - 2018 në programin e studimit "Teknologji ndërtimi" u regjistruan për herë të parë 11 studentë. Në vitin akademik 2018-2019 ky program studimi nuk është aktivizuar për studentë të vitit të parë, dhe aktualisht ndjekin studimet 9 studentë në vitin e dytë të studimeve.

Ky program studimi përkon me Nivelin 5 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, me fokus në krijimin e profesionistëve me aftësi praktike me titullin "Teknik i Lartë".

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi 1: Aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

- Kriteri 1** Punësimi është trajtuar në hartimin e kurrikulave, në karrierën arsimimin, informimin dhe udhëzimet.
- Kriteri 2** Punësimi është një çështje kyçe për miratimin e programit, monitorimin dhe rishikimin e tij.
- Kriteri 3** Studentëve i është dhënë mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit.
- Kriteri 4** Programi parashikon dhe kredite të përfituara gjatë punës
- Kriteri 5** Të përfshijnë inisiativa specifike si psh. mbështetje për sipërmarrjen
- Kriteri 6** Krijimi i lidhjeve punëdhënës / IAL.

Vlerësimi sipas standardit 1:

Programi profesional i studimit në "Teknologji ndërtimi" ofron njohuri të përshtatshme për përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve me aftësi praktike të aftë të japin kontributin e tyre në fushën e teknologjisë së ndërtimit. Hartimi i kurrikulës dhe ndryshimet e bëra në kurrikul gjatë kësaj periudhe tregojnë se Departamenti i EMSA i ka kushtuar rëndësi punësimit të studentëve. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se studentët marin këshillimin e nevojshëm në lidhje me mundësitë e tyre për punësim. Megjithatë një studim tregu i dokumentuar në formë anketimi që do të përfshinte një numër më të gjerë specialistësh dhe palësh të interesuara do të rriste efikasitetin e këtij programi, aspekt që reflektohet në vonesën e hapjes së programit, gjithashtu dhe në ndryshimet e kurrikulës gjatë periudhës midis licencimit dhe implementimit.

Kurrikula e programit profesional në "Teknologji ndërtimi" është në përputhje me kartën e Bolonjës si dhe me udhëzimet përkatëse të MASR. Nevojitet të vihet në dukje se, duke qenë se bëhet fjalë për një program profesional, pjesa aplikative; si ajo e praktikës profesionale dhe ajo e punëve të laboratorit (veçanërisht në lëndët karakterizuese, të kategorisë B) duhet të zënë më shumë peshë respektivisht në kurrikul dhe në silabuse. Megjithëse IAL në kuadër të programit në fjalë ka lidhur marrëveshje me kompani që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit, këto marrëveshje duhen zgjeruar si nga aspekti sasior ashtu dhe nga ai cilësor (marrëveshje me laboratorë që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit).

Konkluzionet e GVJ:

Programi ofron njohuri të përshtatshme për përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve me aftësi praktike në fushën e teknologjisë së ndërtimit.

Në këtë program studimi studentëve u jepet mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit, gjithashtu janë parashikuar dhe kredite të përfituara gjatë punës, por duke qenë se bëhet fjalë për një program profesional, pjesa aplikative; si ajo e praktikës profesionale dhe ajo e punëve të laboratorit (veçanërisht në lëndët karakterizuese, të kategorisë B) duhet të zënë më shumë peshë respektivisht në kurrikul dhe në silabuse. Vihet re nevoja për rritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit si nga aspekti sasior ashtu dhe nga ai cilësor (marrëveshje me laboratorë që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit).

Rekomandime\ sugjerime:

- Rekomandohet rritja e peshës së praktikës profesionale në kurrikulën e programit si dhe dhe ajo e

punëve të laboratorit në silabuset e lëndëve (veçanërisht në lëndët karakterizuese, të kategorisë B).

- Rekomandohet rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me laboratorë që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit.

2. **Struktura akademike e Njesisë Bazë (përgjegjëse për programin e studimit)** **Pjesa përshkrimore**

Për vitin akademik 2015-2016, Kolegji Profesional i Tiranës ka qenë i organizuar në tre Departamente:

- **Departamenti i Teknologjisë së Informacionit,**
- **Departamenti i Elektro Mekanikës, dhe,**
- **Departamenti i Ndërtimit dhe Sistemeve të Aplikuara.**

Në muajin Dhjetor të 2016, Departamenti i Elektro Mekanikës si dhe ai i Ndërtimit dhe Sistemeve të Aplikuara paraqitën projekt propozimin për riorganizim të dy departamenteve në një të vetëm. Senati akademik i Kolegjit Profesional të Tiranës me Vendimin Nr.22 prot, datë 5.12.2016, ka vendosur riorganizimin e Departamentit të Elektro Mekanikës dhe Departamentit të Ndërtimit dhe Sistemeve të Aplikuara, në një Departament të vetëm, i cili u quajt Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara. (Evidenca 6 - Riorganizim Departamenti).

Momentalisht Kolegji Profesional i Tiranës përbëhet nga dy Departamente:

- **Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, dhe,**
- **Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara.**

Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, si pjesë e strukturës së përgjithshme të Kolegjit Profesional të Tiranës, është një nga njësitë bazë mësimore e kërkimore.

Organigrama e KPT është e bazuar në funksione dhe në segmente, sipas parashikimeve të Statutit të KPT (Evidenca 10 - Struktura Organizative e KPT). Struktura organizative e Departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara është pjesë e kësaj organigrame. Organigrama e KPT është e publikuar në faqen zyrtare të KPT <http://kolegjiprofesional.edu.al>

Struktura e organizimit të Departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara pranë KPT përfshin Përgjegjësin e Departamentit si dhe Laboratorët. Në funksion të Departamentit janë edhe njësi të tjera si Sekretaria mësimore por edhe pjesa tjetër e stafit administrativ, të cilët bashkërendojnë punën e tyre për realizimin sa me efikas të proceseve të ndryshme brenda departamentit.

Përgjegjësi i departamentit është autoriteti drejtues akademik i departamentit. Kompetencat e tij janë të përcaktuara në statut (Evidenca 4 – Statuti) dhe në rregulloren e institucionit. (Evidenca 11 – Rregullorja e Institucionit).

Për zhvillimin e kurrikulave mësimore, Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara përbëhet nga shtatë laboratore dhe tre ofcina:

1. Laboratori i HVAC (Heating Ventilation Air Condition) dhe Termoteknikës
2. Laboratori i Pneumatikës dhe Elektropneumatikës, PLC (Programmable Logic Controller)
3. Laboratori i Fizikës
4. Laboratori i Mekanikës dhe Shkencave Materiale
5. Laboratori i Autotronikës
6. Laboratori i Gjeodezisë / Laboratori Gjeospacial
7. Laboratori i Robotikës
8. Laboratori i Materialeve Inxhinierike dhe Elementë Makinash
9. Ofcina e Automjeteve dhe Mekanikës
10. Ofcina e HVAC (Heating Ventilation Air Condition) dhe Termoteknikës
11. Laboratori i Makinave Elektrike

Programi i studimit “Teknologji ndërtimi” kombinon teorinë me praktikën në laboratorë dhe në subjekte pritëse dhe synon të formojë specialistë në fushën e ndërtimit, të aftë për të përmbushur kërkesat dinamike të tregut të


punës. Laboratorët janë pajisur me mjete dhe aparatura tërësisht të reja dhe bashkëkohore. Gjatë punës në laborator studentët kanë mundësi të njihen me teknikat, metodat dhe aparatat e përdorura në lëndë të veçanta, duke e bërë kështu më të lehtë përvetësimin e njohurive. (Evidenca 12 - Përshkrimi i laboratorëve).

Tregues të matshëm:

Struktura didaktike (Departamenti/sectorët) për programin e studimit

Struktura akademike e Departamentit ka në krye Përgjegjësin e Departamentit, dhe stafin akademik që përbëhet nga lektorë dhe asistent lektorë.

Struktura e organizimit të Departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara pranë KPT paraqitet në mënyrë skematike përmes diagramës në vijim:



- Numri i personelit akademik në Departament: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (Tabela 1 në aneks)
 Për vitin akademik 2015-2016: 16 PAE/ 13 PAK
 Për vitin akademik 2016-2017: 11 PAE/ 15 PAK
 Për vitin akademik 2017-2018: 13 PAE/ 13 PAK
 Për vitin akademik 2018-2019*: 12 PAE/ 10 PAK

Shënim: Për vitin akademik 2018-2019 numri i PAK është dhënë vetëm për semestrin e parë.

Stafi administrativ punon për të gjithë institucionin. Ai përbehet nga Sekretarja e Përgjithshme Mësimore, dy sekretare mësimore nga një për secilin departament, Përgjegjësjë e Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, Përgjegjësjë e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Administratori, Financieri, Përgjegjësi dhe Specialisti i Zyrës së IT, Përgjegjësi i Bibliotekës dhe Zyrës së Fotokopjes, 2 persona si dhe Mirëmbajtës i IAL, pra gjithsej 12 persona.

- Shih Statutin e Institucionit (Evidenca 4 – Statuti i KPT)
 Shih Rregulloren e Institucionit (Evidenca 11 – Rregullorja e Institucionit)
 Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës (Dokumenti 4 dhe 5 CV Staf akademik TN 2017-2018 dhe 2018-2019)

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për Programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Në programin e studimit “Teknologji ndërtimi”, zhvillojnë mësim një staf i përbërë nga pedagogë të kualifikuar, të cilët kanë një eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës së tyre në universitetet

publike/private shqiptare dhe në universite të huaja. Në përzgjedhjen e stafit pedagogjik, Departamenti i kushton një vend të veçantë kandidatëve që kanë përvojë në pedagogji si dhe që zotërojnë përvojë pune në ushtrimin e profesionit të tyre. Këtë e dëshmojnë titujt akademikë të pedagogëve, të cilët zhvillojnë lëndët e formimit të përgjithshëm, lëndët e formimit profesional dhe ndjekin praktikën e studentëve, në programin e studimit “Teknologji ndërtimi”.

Momentalisht në Departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara zhvillojnë mësim 12 pedagogë efektiv. Prej tyre dy janë me gradën Prof. Dr. Gjithashtu, në këtë program studimi, japin leksione dhe seminare edhe pedagogë relativisht të rinj që kanë më pak përvojë akademike, por që kanë kualifikimin Master në Shkencë dhe Master Profesional.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik bëhet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, udhëzimet e MASR, kontratën e punës të lidhur mes anëtarit të stafit dhe KPT.

Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me nevojat për pedagogë, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Departamenti si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Synimi kryesor është zhvillimi i ngarkesës mësimore kryesisht me personel të brendshëm e të qëndrueshëm.

Politika, kriteret dhe procedurat e punësimit në KPT, përfshirë këtu edhe për programin e studimit “Teknologji ndërtimi”, rregullohen sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve rregullatore të KPT, sidomos Statuti, Rregullorja e KPT dhe Manuali i Burimeve Njerëzore (Evidenca 26 - Manuali i Burimeve Njerëzore).

KPT pranon aplikime për personel akademik për Departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara dhe veçanërisht në programin e studimit “Teknologji Ndërtimi”, gjatë të gjithë vitit, të cilat ruhen në një “pool database” duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale. Aplikimet mund të dorëzohen dorazi në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KPT, me postë elektronike, ose të dërgohen nëpërmjet aplikimit në faqen e internetit të www.kolegjiprofesional.edu.al

(<http://kolegjiprofesional.edu.al/web/apliko-tani/>)

Përzgjedhja bëhet me seleksionim paraprak dhe intervistë ku theksi vihet gjithmonë te një proces i paanshëm, te aftësia e kandidatit, përshtatshmëria me pozicionin, meritokracia etj

Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:

- Eksperienca në mësimdhënie në nivel universitar;
- Të ketë së paku diplomë në Master Profesional.
- Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore;
- Rezultatet personale të kandidatit;
- Motivet kryesore për t’u bërë pedagog në KPT;
- Aftësitë komunikuese dhe etika;
- Eksperienca e punësimit;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;
- Paraqitja gjatë intervistës me komisionin e posaçëm të rekrutimit;
- Paraqitja gjatë leksionit të hapur para departamentit përkatës (kur aplikohet).

Raste të vecanta: Për shkak të strukturës dhe formës që KPT ka, në KPT mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një eksperiencë të gjatë e të suksesshme në profesion dhe janë unikë në fushën e tyre të specialitetit.

Detajet për rekrutimin e punojësve, të drejtat dhe detyrimet e tyre jepen në manualin e punonjësit përgatitur nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave të KPT. Për të kompletuar deklarinimin e personelit të ri pranë organeve përkatëse, personeli i ri duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave:

◆ **Personeli Akademik Efektiv:**

1. Kontrata Individuale e Punës;
2. CV-në (sipas formatit të BE-së);
3. Dokument identifikimi (fotokopje e kartës së identitetit/ pasaportës);

4. Diplomë të arsimit të lartë të kryer, si dhe dokumente të tjera që vërtetojnë kualifikime, specializime, shoqëruar me listë notash, dhe marrje gradash apo titujsh akademikë e shkencorë, kopje të noterizuara. Nëse diploma e kualifikimit më të lartë është marrë në një institucion jashtë vendit, ajo është e shoqëruar me vendimin e njohjes nga MAS;
5. Librezë shëndetësore;
6. Librezë Pune dhe Librezë Kontributesh për Sigurimin Shoqëror dhe Shëndetësor.

❖ **Personeli Akademik me Kontratë:**

1. Kontrata Individuale e Punës;
2. CV-në (sipas formatit të BE-së);
3. Dokument identifikimi (fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës);
4. Diplomë të arsimit të lartë të kryer, si dhe dokumente të tjera që vërtetojnë kualifikime, specializime, shoqëruar me listë notash, dhe marrje gradash apo titujsh akademikë e shkencorë, kopje të noterizuara. Nëse diploma e kualifikimit më të lartë është marrë në një institucion jashtë vendit, ajo është e shoqëruar me vendimin e njohjes nga MAS;
5. Librezë shëndetësore;
6. Vërtetim page, i cili duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e pedagogut, detyrën që kryen në institucion, NIPT-in e institucionit, pagën bruto mbi bazën e të cilës llogariten kontributet, data e lëshimit, si dhe të identifikohet që vërtetimi lëshohet në adresë të Kolegjit Profesional të Tiranës.
7. Leje nga punëdhënësi kryesor për mësimdhënie në KPT, nëse është i angazhuar si pedagog i brendshëm në një IAL tjetër.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (Shih Tabela 2 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Për vitin akademik 2017-2018, për programin e studimit “Teknologji ndërtimi”, janë angazhuar në mësimdhënie 12 pedagogë nga të cilët 2 me titull Profesor, 1 me titullin Profesor i Asociuar, 1 me gradën Dr, 1 pedagog me MND dhe 7 me MSc. Raporti PAE/PAK ishte 8/4.

Ndërsa, për zhvillimin e këtij programi studimi, për vitin akademik 2018-2019, angazhohen 5 pedagogë me titullin MSc. Raporti PAE/PAK është 2/3.

Nuk mund të japim dot një vlerësim në lidhje me numrin *Personel akademik/Personel administrativ/student* pasi personeli administrativ u shërben të gjitha programeve të studimit që mbështet KPT.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Shih Tabelën 3 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontrata individuale e punësimit, specifikon termat dhe kushtet e punës sipas pozicionit përkatës dhe është hartuar bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi. Kontrata përmbante:

- Emrat e Punëdhënësit dhe Punëmarrësit;
- Data e fillimit të punës dhe periudha e punësimit të vazhdueshëm;
- Pozicioni i punës;
- Pagesa dhe intervalet në të cilat do të paguhet;
- Orët e punës;
- E drejta e lejeve;
- E drejta për raport mjekësor;
- Periudha e njoftimit për përfundimin e marrëdhënieve të punës;

- Kohëzgjatja e punësimit në rast se nuk është e pa caktuar duke specifikuar datat e fillimit dhe përfundimit.

Në kontratën individuale të punës janë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e paleve të cilat duhen respektuar. Këto të drejta janë në përputhje me statutin dhe rregulloren e KPT.

Kontrata e punës që nënshkruhet për stafin akademik efektiv është pa afat, ndërsa për personelin akademik me kontratë është semestrale.

Kontrata e punës për personelin akademik efektiv dhe për personelin akademik me kontrate. (Evidenca 27 - Kontrata Individuale e Punës)

- Ngarkesa semestrale, vjetore etj

Ngarkesa mësimore e personelit akademik dhe format e saj, rregullohen në kontratën e punës të personelit akademik, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e KPT, në rregulloret e KPT, si dhe në dokumentet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të KPT. Si rregull lëndët mbulohen me pedagogë të brendshëm, që kanë titullin/gradën e kërkuar në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për respektimin e parimeve të mësipërme në shpërndarjen e ngarkesës tek personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm, dhe raporton për këtë shpërndarje tek Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave. Ngarkesa mësimore për stafin akademik në KPT është përcaktuar me vendim Rektorati.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës (Dokumenti 7. Stafi akademik ngarkesa TN)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi 2 Aftësi të transferueshme janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Punëdhënësit ndihmojnë në përcaktimin e përvojave thelbësore (p.sh. përvoja e punës) dhe aftësitë ndër-kurrikulare, qëndrimet dhe njohuritë (p.sh. të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi, TIK, marrëdhëniet me klientët)

Kriteri 2 Çdo aftësi është ndjekur përmes moduleve (Përmbajtja e kursit, metodat e mësimdhënies, vlerësimit) në fazat e zhvillimit të kurrikulës dhe nëpërmjet rishikimit të programit.

Kriteri 3 Rezultatet janë të monitoruara (p.sh. punësimi i të diplomuarve).

Vlerësimi sipas standardit 2:

Institucioni ka lidhur marrëveshje në kuadër të programit “Teknologji ndërtimi” me kompani të ndryshme që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit (Evidenca 9 – Marrëveshje me kompani/bizneset). Në hartimin e programit janë reflektuar sugjerimet e mara nga këto kompani për përcaktimin e kualifikimeve të nevojshme për aftësimin e studentëve si në aspektin profesional ashtu dhe atë ndër-kurrikular.

Syllabuset janë në përputhje me natyrën e institucionit për formimin e profesionistëve me aftësi praktike në një periudhë 2 vjeçare. Metodatat e mësimdhënies janë në përputhje me nivelin 5 të studimeve sipas kartës së Bolonjës.

Megjithëse syllabuset e lëndëve përfshijnë kredite të dedikuara për praktikë dhe punë laboratoriale, vlen për tu theksuar mungesa e laboratorëve specifikë të fushës së teknologjisë së ndërtimit pranë institucionit apo marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë që operojnë në treg në fushën e teknologjisë së ndërtimit. Gjithashtu duke qenë se programi i teknologjisë së ndërtimit nuk ka nxjerrë akoma brezin e parë të të diplomuarve monitorimi i të diplomuarve për këtë program studimi nuk mund të vlerësohet, por departamenti i EMSA ndjek dhe monitoron punësimin e të diplomuarve në programet e tjerë që ofron ky departament.

Standardi 5: Stafi zotëron aftësi, sjellje dhe përvojë të duhur për rezultatet e pritshme të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Të dhëna nga specialistë të sektorit përkatës të punësimit

Kriteri 2 Staf i mësimdhënës angazhohet në përditësimin e mëtejshëm, specifikisht për anën profesionale, lëndët dhe vendet e punës

Kriteri 3 Janë ngritur sisteme për evidentimin e hershëm dhe ofrimin e mbështetjes, për mbështetjen e të mësuarit tek studentët

Kriteri 4 Staf i siguron mbështetje për studentët me kohë të pjesshme (part time), p.sh. nëpërmjet email-it, ofrimit të të mësuarit virtual dhe ambienteve përkatëse (e-learning).

Vlerësimi sipas standardit 5:

Departamenti EMSA çdo vit akademik i miraton sylabuset sipas një procedure të parapërcaktuar. Nga dokumentacioni shoqëruar i RVB dhe vizita në IAL u konstatua se stafi PAE dhe PAK në shërbim të programit të studimit “Teknologji ndërtimi” kanë eksperiencë të mëparshme si në aspektin akademik ashtu dhe në atë të tregut të punës, gjë që ndihmon në përditësimin e njohurive të stafit në përputhje me nevojat e tregut.

Nga vizita në IAL dhe dokumentacioni shoqëruar u evidentua gjithashtu se IAL ka mekanizmat dhe procedurat e nevojshme për evidentimin e hershëm dhe mbështetjen e studentëve me anë të NJBSC në rastin kur problematikat vijnë si pasojë e stafit dhe me organizimin e aktiviteteve mbështetëse kur vihet re nevoja nga ana e studentëve. Studentëve gjithashtu ju ofrohet me kohë të pjesshme me anë të sistemeve online. Mbështetja e studentëve nga Zyra e planifikimit të karrierës gjatë gjithë ciklit të studimit u evidentua si në takimin me personelin e zyrës ashtu dhe gjatë bisedës me studentët.

Konkluzionet e GVJ:

Në hartimin e programit të studimit “Teknologji ndërtimi” janë reflektuar sugjerimet e mara nga kompani që operojnë në fushën e teknologjisë së ndërtimit për përcaktimin e kualifikimeve të nevojshme për aftësimin e studentëve si në aspektin profesional ashtu dhe atë ndër-kurrikular..

Ndërkaq çdo aftësim është ndjekur përmes moduleve, si përmbytja e programit, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, rishikimi i programeve, etj.

Stafi në shërbim të programit të studimit është i angazhuar në përditësimin e njohurive duke qenë në kontakt dhe me tregun e punës. Studentët mbështeten nga stafi akademik gjithashtu dhe nga njësitë e tjera në shërbim të programit si NJSBC dhe Zyra e planifikimit të karrierës. Gjithashtu studentëve i ofrohet ndihmë me kohë të pjesshme me anë të praktikave online.

Rekomandime/Sugjerime

Rekomandohet që sa më shpejt të jetë e mundur të ngrihen laboratorë specifikë në shërbim të programit të “Teknologjisë së ndërtimit”. Minimalisht studentët duhet të kenë mundësi të zhvillojnë disa prova bazike në lidhje me vetitë fizike dhe mekanike të materialeve të ndërtimit.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

KPT shpk ndodhet me seli në adresën: Njësia Bashkiake numër 4, rruga “Xhanfize Keko”, Kompleksi “Xhura”, zonë Kadastrale 8130, me numër pasuri 5/200, Tiranë, në ambientet e marra me qira në bazë të kontratës së Qirasë numër Rep. 3758, No. Kol. 1044, datë 29/09/2015, të ndryshuar, për një sipërfaqe totale prej 2.980 m², si dhe ambientet ndihmëse dhe mundësi zgjerimi në të ardhmen me një potencial deri në 12.000 m², (duke përbushur kështu kërkesat ligjore për arsimin e lartë profesional për një numër total prej rreth 2.400 studentësh). Vendndodhja aktuale është lehtësisht e arritshme nëpërmjet mjeteve të transportit publik.

Godinat e Kolegjit Profesional të Tiranës janë të vendosura brenda kompleksit të ndërtesave, të quajtur “Kompleksi Xhura”, në një zonë totale prej 14 000 m², që në vetvete është i përbërë nga 12 godina.

Hapësira e marrë me qira nga KPT shpk në bazë të Kontratës së Qirasë, përfshin një sipërfaqe prej 2.980 m², të përdorimit akademik duke marrë parasysh që: KPT ka marrë me qira katin e parë (përdhës), katin e dytë

(pjesërishtë) dhe katin e fundit (të katërt), në objektin e referuar si Godina Nr.2 në planimetrinë bashkëngjitur të Kontratës së Qirasë.

Kati i parë ka një sipërfaqe prej 1.020 m², kati i dytë ka një sipërfaqe 480 m², ndërsa kati i katërt ka një sipërfaqe prej 1.200 m². Kjo hapësirë është përdorur për klasa, laboratorë dhe zyra. Një sipërfaqe prej 280 m² gjendet në Godinën 1C (kati përdhes) siç përshkruhet në planimetrinë bashkëlidhur Kontratës së Qirasë. Kjo hapësirë përdoret për laboratorë/ofiçina. Ambientet janë të rrethuar me hapësira të gjelbra /lulishte të vogla, të pajisura me stola dhe kosha për mbeturinat.

Pjesa e mbetur përfshin: vend parkim, hapësirë çlodhëse (parqe të vogla), një kafene, dhe një fushë futbollit. Duke qenë se objektet janë të vendosura brenda një kompleksi ndërtesash, hapësirat e përbashkëta janë dhe nën mbikqyrjen e një ekipi të mirëmbajtjes, që përfshin kopshtar, mirëmbajtës etj. dhe për këtë mirëmbajtje, KPT paguan një tarifë mujore, siç parashikohet në pikën 5 të kontratës së qirasë.

Për sa i përket hapësirave akademike, ato janë të bollshme në aspektin e lartësisë, ndriçimit dhe ajrosjes. Çdo kat është 4 metra i lartë. Materialet e ndërtimit të përdorura janë cilësore dhe garantojnë gjithashtu një izolim të sigurt nga zhurmat duke siguruar kështu akustikën e duhur.

Të gjitha objektet janë të pajisura me mjete mbrojtjes kundër shkarkimeve elektrike (4 rrufepritëse) dhe paisje të mbrojtjes nga zjarri. Të gjitha fikset e zjarrit janë të vendosur në vende të dukshme dhe lehtësisht të arritshme në rast emergjence zjarri. Ato kontrollohen dhe zëvendësohen në mënyrë periodike, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ambientet janë të pajisura gjithashtu me detektorë me ndjeshmëri të lartë kundër zjarrit të cilët janë vendosur në tavanet e ambienteve.

Katet janë të lidhura me anë të shkallëve të brendshme, ato janë të gjera dhe me lartësi normale, Gjithashtu, është bërë gati dhe hapësira për ashensorin, i cili është planifikuar të vendoset në punë brenda një periudhe afatshkurtër. Ambientet akademike gjenden në Godinën Nr.2 të kompleksit dhe janë të pajisura rregullisht me dy palë shkallë (ato të brendshme dhe shkallët e emergjencës të vendosura në katin e katërt të Godinës Nr. 2 që mund të përdoren në rast emergjence). Gjithashtu në katin e parë të Godinës Nr.2 janë tre dalje që mundësojnë një evakuim të sigurt në rast emergjence.

Mjediset janë të kompletuara me sistemin e ngrohjes të tipit Daikin. Ky sistem është tërësisht funksional, i certifikuar dhe mirëmbahet rregullisht në mënyra periodike nga shoqëria instaluese.

Tregues të matshëm:

- Mjediset e institucionit në funksion të programit të studimit (Shih Tabelën 4 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (Shih Tabelën 5 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)
- Shpenzimet për vitet e zhvillimit të programit sipas burimit të financimit
Gjatë vitit akademik 2017 – 2018, ndjekin studime 514 studentë. Kosto për studentë është 191.965 lekë. Të dhënat e studentëve vit pas viti tregojnë një rritje të numrit të studentëve nga viti i parë në vitin e dytë, njëherazi shprehin edhe rritjen e interesit për të studiuar në KPT, kjo gjë dëshmohet dhe në larmishmërinë e profileve që ofron, cilësinë e zhvillimit të veprimtarive akademike si dhe mundësi të ofrohen në një mjedis bashkëkohor.
KPT garanton qëndrueshmëri financiare me qëllim zhvillimin normal të veprimtarisë akademike, në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore dhe në përputhje me standartet e cilësisë.
- Kosto e studimit/për student për një vit akademik
Pasqyrat financiare të KPT-ës miratohen nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të KPT-ës dhe depozitohen elektronikisht në Zyrën e Tatimeve dhe në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke qënë kështu të aksesueshme në çdo kohë nga publiku i gjerë. KPT dokumenton

pasqyrat financiare të tre viteve kalendarike të vitit 2015, 2016 dhe 2017. KPT shqyrton dhe analizon në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. KPT ushtron veprimtarinë e saj që prej vitit 2015. Ajo nuk përmbush kriteret për të qenë subjekt për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, megjithatë KPT çdo vit harton një raport në lidhje me transparencën financiare.

Rezultati: Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjëndjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit 2015, 2016 dhe 2017, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës
Bilanci Vjetor 2015
Bilanci Vjetor 2016
Bilanci vjetor 2017

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, KPT ka themeluar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) e cila kryen punë të vazhdueshme për monitorimin e veprimtarisë së institucionit dhe sigurimin e cilësisë së brendshme.

Kjo njësi e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, nga 28 Dhjetori i vitit 2015 e në vazhdim, në formën e një ekipi të përbërë nga pedagogë që përfaqësojnë Departamentet e KPT-së, një përfaqësues nga njësitë ndihmës, një anëtar - ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. Në përbërjen e NjSBC përfshihet dhe një përfaqësues nga studentët dhe një ekspert i jashtëm për të mundësuar një mendim objektiv dhe nga studentët dhe nga palë jashtë KPT.

Kompetencat dhe funksionimi i NjSBC rregullohet në mënyrë të hollësishme me “Rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Kolegjin Profesional të Tiranës” (Evidenca 16 – Rregullorja e NjSBC-së).

Ndër detyrat kryesore që ka realizuar dhe ka NjSBC janë:

- Vlerësimi, rishikimi dhe përmirësimi i programeve dhe syllabuseve mësimore;
- Mbarëvajtja e zhvillimit të procesit akademik;
- Realizimi i orarit të zhvillimit të orëve të mësimi, leksione, ushtrime, laboratore dhe praktika mësimore;
- Zhvillimi i procesit të vlerësimit të pedagogëve për çdo lëndë nga ana e studentëve;
- Mbarëvajtja e zhvillimit të provimeve përfundimtare dhe cilësia e korrigjimit të tyre;
- Vlerësimi i procesit të organizimit të praktikave profesionale dhe cilësisë së realizimit të tyre
- Monitorimi i sekretarisë mësimore për proceson e hedhjes së notave;
- Monitorimi i vlerësimit të pedagogëve më të rinj nga ana e pedagogëve më me përvojë etj.

Aktivitetin e saj NjSBC e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendarik të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollet në njësitë apo proceset që i nënshtrohen kontrollit, e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike NjSBC informon drejtuesit e Departamenteve, e përmes tyre të gjithë stafin e KPT, rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësitë të tij bazë dhe anëtarëve të personelit.

Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për përditësimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e akteve rregullatore të KPT.

Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike, të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në KPT, legjislacionin përkatës, përfshirë dhe aktet rregullatore të KPT.

Impakt të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, si edhe pyetësorët me frekuencë semestrale apo dhe ato mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog.

Monitorimi i mësimdhënies realizohet dhe nga tutoriatet që zhvillohen me studentët mbi bazën e një orari që bëhet publik çdo fillim semestri.

Gjatë takimeve të tutoritit janë ngritur ose konstatuar çështje të natyrave të ndryshme si për shembull: problematika mbi mësimdhënien; vështirësitë në punimin e punëve të laboratorëve, gjallërimi i jetës studentore dhe përfshirja e studentëve në projekte e aktivitete të ndryshme, etj., çështje të cilat më pas janë ngritur dhe në strukturat përkatëse dhe janë adresuar.

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

NJBSC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive të institucionit. Ajo ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë, mjete në funksion të saj janë:

• Vlerësimi i performancës dhe punës së stafit dhe cilësisë së mësimdhënies nga eprori, përgjegjësi i departamentit/një koleg i caktuar nga ai ose NJSBC.

Vetë përgjegjësi i departamentit ose duke ngarkuar një nga antarët më me eksperiencë të stafit akademik të departamentit, asiston në orë mësimi të zhvilluar kryesisht nga pjestarët e rinj të departamentit, për të vlerësuar dhe ndihmuar në përmirësimin e mësimdhënies (pasqyrimi i vlerësimit bëhet sipas formatit për vlerësimin e pedagogut nga eprori /kolegu).

• Për të siguruar një cilësi sa më të lartë në tërësinë e procesit mësimor, KPT ka hartuar një pyetësor për studentet, për të parë se si ata vlerësojnë punën e pedagogut përkatës në mësimdhënie, në të tre komponentet: leksione, ushtrime dhe laboratore. Ky pyetësor organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha lëndët dhe pedagogët e programit të studimit dhe konsiston në:

- mënyrën se si pedagogu e zhvillon orën e mësimi

- qartësinë gjatë shpjegimit

Shembulli i formularit të vlerësimit të pedagogut gjendet në (Dokumentin 30. Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët)

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Nga vizita pranë Kolegjit Profesional të Tiranës dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion, pas takimit, GVJ konstaton se: KPT është organizuar dhe vepron si një institucion jo-publik, me karakter akademik dhe shkencor, që ofron programe të nivelit profesional që përkojnë me kategorinë e pestë të kualifikimit.

Departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara pranë "KPT" është pjesë përbërëse e institucionit dhe një nga dy departamentet e tij. Programi i studimit "Teknologji ndërtimi" është i orientuar drejt aplikimit konkret të dijeve në fushën e Inxhinierinë e Ndërtimit. Ky program mbëshetet në ciklin

parauniversitar i përgjithshëm ose profesional në fushën e ndërtimit. Programi është i organizuara në module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve (ECTS). Ky program studimi zgjatë dy vite akademike me 120 kredite.

Duke u bazuar në RVB, Programi i studimit Profesional Jouniversitar 2-vjeçar Teknologji Ndërtimi ka për qëllim të hedhë bazat teknike dhe përgatitjen teoriko - praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si Teknikë i lartë në fushën e teknologjisë së ndërtimit. Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës 2-vjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara.

Të diplomuarit në këtë program do të mund të punësohen në kompani ndërtimi, sipërmarrje private apo profesionist të lirë në fushën e zbatimit të ndërtimit.

Objektivat e programit: "Teknologji ndërtimi", duke cituar RVB janë:

Studentët e programit profesional në "Teknologji ndërtimi" pajishen me:

njohuri për të lexuar dhe analizuar projektet e specialistëve përkatës dhe për t'i implementuar ato në vepër.
• *njohuri të teknologjive më të përdorshme të ndërtimit, të vetive e materialeve të ndërtimit dhe mënyrën e vendosjes së tyre.* • *njohuri të theksuara në fushat e aplikimit të projekteve, në teknologjitë e sotme të ndërtimit, llogaritjeve të thjeshta inxhinierike, matjeve, njohjes së materialeve të sotme të ndërtimit etj.* • *mundësi për të hyrë në tregun e punës në fushën e aplikimit të projekteve arkitektonike, veprave inxhinierike, ndërtimit të rrugëve, mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit të objekteve ndërtimore të tipologjive të ndryshme, etj.*

Ky program studimi pajis studentin me aftësi për t'u specializuar brenda një kohe të shkurtër edhe në mënyrë autonome, mbi bazën e kërkesave të tregut të punës. Programi përgatit specialistë të mirëfilltë në fushën e ndërtimit, si pjesë përbërëse e zinxhirit projektues të ndërtesave me funksione të ndryshme.

Kurrikula e këtij programi studimi hartohet nga departamenti përkatës dhe miratohet nga rektorati. Kurrikula gjëndet brënda tabelës 7 në aneks. Ndarja e lëndëve në tipe veprimarie ndodhet brënda tabelës 8 në aneks.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga vizita në institucion u konstatua që ka një ndryshim të konsiderueshëm nga kurrikula e licencimit tek kurrikula që është në fuqi aktualisht. Ky është një aspekt pozitiv i programit dhe institucionit pasi kjo tregon që programi është dinamik dhe kërkohet përmirësim i vazhdueshëm. Por një sugjerim do të ishte, që të ishte testuar një herë kurrikula e licencimit dhe më pas të ishin bërë ndryshimet. Një aspekt pozitiv i përditësimit të kurrikulës ishte shtimi i orëve të praktiës duke qënë se programi këtë ka për fokus të aftësoj mbi të gjitha në aspekt praktik studentin më pas në aspekt teorik. Por këto orë kanë nevojë të shtohen akoma më shumë. Një tjetër element që kërkon vëmendje është shpërndarja e orëve në leksione, seminare, laborator, etj. Nga kurrikula vihet re që kjo ndarje është e njëjtë për të gjitha lëndët. Kjo është paksa e vështirë pasi jo të gjitha lëndët kanë të njëjtën nevojë për leksione seminare etj. Sugjerohet të shikohet më me vëmendje shpërndarja e orëve.

Plani mësimor për programin e studimit (Shih tabelën 7 në aneks, plani mësimor që IAL ka paraqitur në RVB)

- Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të studimit (Shih Tabelën 8 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)
Per kurrikulën e vitit akademik 17-18 vihet re që lëndë me zgjedhje është "Menaxhim i punimeve në kantier". Kjo është një lëndë mjaft e rëndësishme për këtë program studimi ndaj rekomandohet që mos të jetë nën kategorinë me zgjedhje por të jetë nën kategorinë karakterizuese.
- Organizmi i programit të studimit (vite, semestra, javë, etj.)

> 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore pune të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

- Vlerësimi i Syllabus-eve për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elementë:
 - Emërtimi i lëndës/modulit
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
 - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
 - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
 - Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
 - Format e vlerësimit të studentëve
 - Detyrimet e studentit për lëndën
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Struktura e cdo syllabusi është përmbajtësore dhe ato pasqyrojnë elementet e nevojshme, duke filluar nga titullari i lëndës, përshkrimi i përgjithshëm i lëndës, objektivat e lëndës të cilat janë të detajuara për secilën lëndë janë nën ombrellën e objektivave të përgjithshme të profilit. Syllabuset përmbajnë brenda vetes edhe rezultatet e nxënies. Ky i fundit është një element shtesë mjaft i nevojshëm brenda një syllabusi.

Një element që u mungon syllabuseve janë edhe format e mësimdhënies dhe metodologjia e ndjekur për ti arritur ato. Sygjerohet të shtohet ky element në syllabuset e ardhshme

- Vlerësimi i Syllabus-eve nga ana cilësore

Për secilën lëndë mësimore të programit të studimit, syllabuset ju prezantohen studentëve në fillim të semestrave përkatëse. Nga vizita në institucion u verifikuan të gjitha syllabuset e lëndëve për programin e studimit dhe konstatojmë se janë në përputhje me standardet.

Nga analiza e cilësisë së syllabuseve rezulton se ato janë në përputhje me kërkesat e programit të studimit, gjykuar nga përmbajta e tyre, përkatësisht nga specifikat e veçanta (pesha e tyre, orët, kreditë ECTS, kërkesat për studentin), njohurit e nevojshme e të domosdoshme që e përgatisin studentin.

- Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara (Shih Tabelën 9 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Në total janë 24 ECTS të ndryshuara që nga plani i licencimit.

- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Shih Tabelën 10 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Në këtë program studimi rekomandohet angazhim i më shumë pedagogëve me kohë të plotë pasi ngarkesa akademike e disa petagogëve është shumë e lartë për këtë program studimi.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Gjatë vizitës në IAL u kërkuan syllabuset dhe këto të fundit na u dhanë

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 6: Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane.

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Kriteri 2 Studentët janë të pajisur me Supplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e BE-së për diplomim

Kriteri 3 Arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, lejojnë regjistrimin në këtë program studimi

Kriteri 4 Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionalë) u

ofrohet mbështetje e duhur që në fazat e hershme të programit.

Kriteri 5 Programit ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në vitin e 3, të një programi bachelor.

Kriteri 6 Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve.

Kriteri 7 Rreth 25% e programit është i vendosur në punë konkrete (p.sh. në një semestër ose i vendosur në pushimet e verës) ose në shkëmbime ndërkombëtare (p.sh. Erasmus +).

Kriteri 8 Mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur në vlerësim dhe rivlerësim.

Vlerësimi sipas standardit 6:

Programi i studimit profesional në “Teknologji Ndërtimi” është hartuar dhe organizuar në përputhje me kartën e Bolonjës dhe kornizën Evropiane të kualifikimeve. Programi akoma nuk ka nxjerrë të diplomuarit e parë megjithatë tek dokumentat e vënë në dispozicion nga GVB, tregohet formati i diplomës. Në këtë program studimi mund të regjistrohen si student që vijnë nga shkolla të mesme të përgjithshme ashtu edhe nga ato profesionale. Për studentët që vijnë nga shkollat e mesme të përgjithshme, semestri i parë i vitit të parë shërben si hyrje dhe prezantim me programin. Ky program studimi ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në programe universitare. Shpërndarje e praktikës dhe teorisë nuk është në masën 50 me 50, ashtu sic nuk janë edhe format e vlerësimit. Por ky nuk është element kufizues pasi ky program është licencuar dhe operon sipas vendimeve të cilat nuk e kishin të detyrueshme pasjen e këtyre raporteve. Për shkak të kohës së shkurtër të programit akoma nuk kemi implementim të mobiliteteve apo semestrave jashtë auditorit.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit në “Teknologji ndërtimi” është në linjë me kartën e Bolonjës dhe legjislacionin në vend. Vihet re që pjesa më e madhe e lëndëve ka kredite të plotëpjestueshme me 3, gjë që lehtëson procesin e transferimit. Sygjerohet që lëndët që kanë kredite që nuk plotëpjestohen me 3 te ritet apo ulet numri i krediteve që të kthehet në këtë formë. Programi ofron njohuri të përshtatshme për përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve me aftësi praktike në fushën e teknologjisë së ndërtimit.

Rekomandime\ sugjerime:

- Rekomandohet rritja e peshës së praktikës profesionale në kurrikulën e duke qënë se praktika zë vetëm 21 ECTS brenda programit të studimit
- Rekomandohet rritja e numrit të orëve të kryera jashtë auditorit pranë kompanive apo laboratoreve
- Rekomandohet shtimi i metodologjisë së mësimdhënies në sylabus
- Rekomandohet përfshirja e këtij programi studimi në projektet Erasmus+ ose të ngjashme me to
- Rekomandohet ulja e numrit të lëndëve dhe rritja e peshës së lëndëve karakterizuese. Vihet re që programi ka 21 lëndë në total (19 lëndë plus praktika dhe provimi final).
- Rekomandohet që vlerësimi final të kryehet nëpërmjet një projekti aplikativ dhe jo nëpërmjet një provimi final. Duke parë karakterin praktik dhe profesional të programit ky provim nuk i shkon për shtat profilit.

8. Mësimdhënia

Piesa përshkrimore

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GVJ konstaton se: Kolegji Profesional i Tiranës vepron mbi bazën e një game të plotë rregullash e procedurash të përcaktuara në rregulloren e studimeve. Të gjitha rregulloret janë të publikuara dhe i komunikohen gjithë stafit përmes formave zyrtare. Lloji i studimit të programit profesional në “Teknologji ndërtimi” është me kohë të plotë.

Programi zhvillohet në gjuhën shqipe.

Programi përbëhet nga 21 lëndë, nga të cilat një praktikë profesionale, dhe një provim final.

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.

Instrumentet e mësimdhënies të cilat zbatohen në Kolegjin Profesional të Tiranës janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë procesit të mësim dhënies, përvojë të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të angazhuar si dhe eksperiencë praktike pune të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në mësimdhënie.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies e vendosin pedagogun në rolin jo vetëm të lektorit por edhe të bashkëpunorit.

Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit (laborator testimi materialesh, laborator gjeoteknike, etj) është një element që duhet marrë në konsideratë për tju shtuar gamës së laboratoreve që IAL zotëron. Duke qenë shkollë profesionale komponenti aplikativ është shumë i rëndësishëm dhe studentët do ta prekin më nga afër nëpërmjet këtij laboratorit.

Procesi i mësimdhënies përbëhet nga leksioni, seminare dhe praktikat, të parashikuara sipas çdo lënde.

Viti akademik fitohet 60 kredite ECTS. Diploma fitohet pas marrjes së paku 120 kredite (ECTS). Niveli i suksesit të studentit vlerësohet në bazë të provimeve finale, detyrat dhe labororet.

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit, (Shih Tabelën 11 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Nga RVB shihet se shpërndarja e orëve është si më poshtë:

Leksione	343
Ushtrime	456
Laboratore	336
Praktikë profesionale	210

Këtu shihet që praktika profesionale ka më pak orë nga të gjithë komponentët. Gjithashtu shihet që leksionet dhe labororet kanë orë të krahasueshme. Si një program profesional duhet ritur numri i orëve të praktikës profesionale dhe i laboratoreve dhe të ulet nr i leksioneve teorike.

- Format e kontrollit të njohurive (Shih Tabelën 12 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Forma e kontrollit të njohurive është e unifikuar për të gjitha lëndët. Rekomandohet që lëndë të ndryshme të kenë shpërndarje të ndryshme të komponentëve të vleresimit pasi çdo lëndë ka dinamikat e veta brënda saj.

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (Shih Tabelën 13 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Nga tabela 13 shihet një numër i ulët i studentëve të angazhuar në aktivitetet. Kjo është e justifikuar nga numri i ulët i studentëve dhe nga vitet e pakta të programit

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

9. Studentët

Piesa përshkrimore

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GJV konstaton se: Qasja e parë e një kandidati për të aplikuar për studime në Kolegjin Profesional të Tiranës është faqja e internetit dhe forma e formularit e cila plotësohet nga kandidati me shënime personale biografike Pas marrjes së informatave të përgjithshme nga Zyra e Pranimeve, aplikantët shoqërohen për të marrë informacion më të detajuar nga pedagogët përkatës. Lista e

dokumentacionit të regjistrimit e cila përmban: diplomë të shkollës së mesme, transkripti i notave të shkollës së mesme, vetëdeklarata notoriale (mbi regjistrimin), ID, kontratë, certifikate

Në Kolegjin Profesional të Tiranës studentëve u transmetohet, nëpërmjet strukturave përkatëse i gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitetet të ndryshme të procesit mësimor, etj. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma:

a. format fizik, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve.

b. Në format fizik të shpallura /të publikuara në mjediset e përcaktuara të Kolegjit Profesional të Tiranës si orari i mësimi, njoftime të ndryshme, pjesë të rëndësishme të rregullores, rezultatet e kontroleve, etj.

c. Në format elektronike në faqen zyrtare të Kolegjit Profesional të Tiranës në internet: <http://kolegjiprofesional.edu.al/>

Gjithashtu informacioni i nevojshëm merret edhe përmes sistemit të informacionit Classter, i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimimit të informacionit të Studentëve, si orari i mësimi, orari i sezoneve të provimit, rezultatet, etj.

Lejohet transferimi i studentëve në vitet e ndërmjetme nga IAL të tjera, brenda dhe jashtë vendit, në Kolegjin Profesional të Tiranës dhe anasjelltas dhe në programet e studimeve universitare pas ekuivalencës së provimeve, sipas kurrikulave përkatëse. Transferimi midis programeve të ciklit të njëjtë lejohet.

Nga vizia në institucion dhe nga dokumentat e shqyrtuar rezultojnë si më poshtë:

Institucioni ka filluar me gjeneratën e parë në këtë program të studimeve në vitin 2017/2018, gjenerata e dytë e regjistruar është në vitin 2018/2019;

Viti akademik 2017-2018 gjithsej 12 studentë, (3 të crregjistruar; 1 i pezulluar;)

Në vitin e dytë aktualisht ndjekin studimet 3 studentë.

-Viti akademik 2018-2019 gjithsej 0 studentë

Për vitin akademik 2017-2018 si dhe 2018-2019, procesi i pranimit të studentëve u krye nëpërmjet aplikimit elektronik në faqen zyrtare të maturës shtetërore, në Portalin U-Albania, proces i udhëhequr nën monitorimin e Rrjetit Akademik Shqiptar dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore si dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Procesi i regjistrimit u krye në përputhje me parashikimet e Udhëzimit Nr. 18 datë 21.05.2018, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimit me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2018-2019".

Maturantët aplikojnë online me formular aplikimi për programet e studimit që ata dëshironin dhe më pas Qendra e Shërbimeve Arsimore komunikoi në mënyrë zyrtare listën e kandidatëve/aplikantëve të cilët kishin aplikuar për programet e studimit të Kolegjit Profesional të Tiranës.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Në këtë program studimi mund të regjistrohen ata kandidat që kanë fituar diplomë nga shkolla e mesme së bashku me provimet e maturës, e cila është e përshkruar në rregulloren e programit të studimit, i cili e zgjedh KPT në portalin U-Albania

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Institucioni ka rregulloren për regjistrim të studentëve. Ka një mori kërkesash lidhur me dokumentacionin dhe kushteve për regjistrim në këtë program studimi.

Mesatarja hyrëse e studentëve në vitin e parë të studimit është 6.5. Mesatarja dalëse nuk mund të llogaritet akoma pasi nuk kemi akoma student të diplomuar

Për punësimin e studentëve i ndihmon mjaft stafi administrative i dedikuar në gjetjen e partnerëve vendas dhe të huaj. Studentët u shprehën mjaft të kënaqur lidhur ndihmesën e dhënë nga IAL për punësim, me dijet e fituara,

etj. Biblioteka është një komponent shumë i rëndësishëm që i vjen në ndihëm studentit. Gjatë vizitës në IAL u konstatua që aty gjënde një numër i limituar titujsh. Rekomandohet shtimi i titujve në gjuhën shqipe.

Gjatë vizitës së Institucionit GVJ ka verifikuar procesin administrimit të notave nga mësimdhënësit deri te administrata, procesi i parashtrimit të ankesës së studentit për provim dhe zgjidhja e saj, regjistrat themeltar, regjistrat ditor, dosjet e studentëve, etj.

I gjithë procesi është transparent. Rekomandohet të hartohet një procedurë për rastin e gabimeve në regjistrat e notave dhe sygjerohet vënëmdje më e madhe në hedhjen e notave në regjistrat.

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Kushte specifike të pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Shih Tabelën 14 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Për momentin nuk ka asnjë mobilitet të studentëve

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 3: Qasja e studentëve në mësimdhënie është mbështetur përmes hartimit të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Hartimi i Programit të studimit është mjaftueshëm fleksibel për të mundësuar që studimi të përshtatet me punësimin.

Kriteri 2 Përvojat e studentëve të fituara nga puna e tyre e mëparshme, janë integruar në modulet dhe vlerësimin e studentëve.

Kriteri 3 Përmbajtja e Programit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit.

Kriteri 4 Vlerësimi dhe feedback-u i studentëve është përdorur në mënyrë efektive, për të mbështetur studentët jo tradicionale dhe të mësuarit e nxënësveve performancë të ulët

Kriteri 5 Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve të ndryshëm, p.sh. të mësuarit në veprim, puna në ekip dhe të mësuarit në formë të pavarur.

Vlerësimi sipas standardit 3:

Programi i shkollës profesionale "Teknologji ndërtimi" është hartuar duke u bazuar në ekperiencat e ngjashme jashtë vendit dhe gjithashtu edhe në programet bachelor brenda vendit. Ky program i përgatit studentët për tregun e punës në fushat e menaxhimit të kantierit dhe jo vetëm. Ky program studimi është i mirë organizuar. Rekomandohet ulja e lëndëve teorike dhe shtimi i atyre aplikative. Mësimdhënia brenda këtij programi studimi është e organizuar në leksione, ushtrime dhe laborator. Praktika profesionale është 1 kredit i çdo lënde. Edhe këtu rekomandohet që të ketë një shpërndarje më dinamike të orëve të lëndës. Lëndë të ndryshme kanë nevojë të ndryshme. Metodatat e mësimdhënies nuk janë të paraqitura në sylabuset e lëndëve. Nga vizita në IAL na u tha që mësimi organizohet në format klasike të tij: Leksione, ushtrime dhe praktikë. Sygjerohet që të rritet numri i orëve jashtë auditorit për këtë program studimi.

Standardi 4: Rezultatet e të mësuarit komunikohen që nga pranimi i studentëve deri në diplomim dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Informacioni për mundësitë e regjistrimeve është i qartë dhe i publikuar, si dhe i mbështetur me udhëzime ndihmuese të stafit.

Kriteri 2 Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL.

Kriteri 3 Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli

Kriteri 4 Monitorimi i bibliotekës dhe i burimeve të tjera të mësimdhënies dhe të të nxënësve është bërë rregullisht. Janë ndërmarrë rregullisht praktika specifike të punësimit dhe zhvillimi i aftësive.

Vlerësimi sipas standardit 4:

Referuar RVB, informimi dhe ndërgjegjësimi për t'u regjistruar në Kolegjin Profesional të Tiranës (KPT) realizohet në përputhje me "Politikën e procedurat e Komunikimit në KPT" nëpërmjet këtyre formave:

1. Organizim i takimeve informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuere të përfaqësuesve të KPT me nxënësit e shkollave të mesme të Tiranës dhe të qyteteve të tjera të vendit në mjediset e tyre;
2. Organizimi i ushtrimeve, i tryezave të rrumbullakëta, dhe i veprimtarive të tjera me karakter mësimor-informues-argëtues me nxënësit e shkollave të mesme të vendit në mjediset e Kolegjit Profesional të Tiranës;
3. Përgatitje e shpërndarje e materialeve informuese, sqaruese, ndërgjegjësuere (si fletëpalosje, postera, broshura etj.), dhe të materialeve audio vizive ne media te ndryshme si: spote promocionale, mesazhe promocionale etj;
4. Dalje publike të përfaqësuesve të KPT në media dhe /ose evente të ndryshme;
5. Organizim logjistik, orientues, me mbështetje, brenda burimeve njerëzore të Kolegjit Profesional të Tiranës për të interesuarit të cilët informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe gjithashtu pajisen me dokumentacionin përkatës.
6. Pjesëmarrje në panairë dhe/ose evente të tjera të ngjashme; pjesëmarrje në Codeëek si një mundësi për të tërhequr të rinjtë në fushat me interes të të rejave të teknologjisë, nëpërmjet demonstrimeve konkrete nga ana e stafit të kualifikuar të KPT
7. Komunikim nëpërmjet faqes zyrtare të KPT dhe / ose llogarive në rrjetet sociale;

Gjithashtu Kolegji Profesional I Tiranës organizon veprimtari/ aktiviteteteve staf-student të tilla si turet nëpër shkollat e mesme, për të informuar cdo maturant mbi programet e studimit që KPT ofron, kushtet dhe kriteret e pranimit etj.

Biblioteka është një element që ka nevojë të plotësohet në mënyrë që të ritet përthithja e informacionit. KPT është shumë i angazhuar në punësimin e studentëve të tij, për këtë arsye brenda IAL ekziston zyra e këshillimit të karrierës dhe punësimit, e cila funksionon si një instancë informuese dhe ndërmjetësuese mes studentëve dhe tregut të punës. Rekomandohet të rritet vizibiliteti i KPT në mediat sociale dhe jo vetëm në mënyrë që kjo shkollë të jetë sa më atraktive për të rinjtë që duan të ndjekin një arsim profesional. Rekomandohet që për vitet e para deri sa shkolla të krijojë themele të forta të përdoren politika favorizuese gjinore, për shtresat në nevojë dhe për ata me mesatare mbi 6. Në këtë mënyrë do të ketë një numër më të lartë studentësh. Gjithashtu duhet punuar që të jenë vetë kompanitë e ndërtimit që sjellin stafin e tyre për tu arsimuar.

Konkluzionet e GVJ:

GVJ ka konstatuar se programi i studimit në "Teknologji Ndërtimi" është mjaftueshëm interesant dhe fleksibël për studentët. Ofrohet një sasi e mirë praktike. KPT në mënyrë të vazhdueshme punon për reklamimin e këtij programi studimi dhe jo vetëm. Por fakti që këtë vit akademik nuk ka asnjë të regjistruar tregon që dicka ka çaluar në procesin e marketimit dhe thithjen e studentëve. Në tërësi është një program shumë i mirë studimi. Studentët informohen për programin e studimit, organizimin, kohëzgjatjen, format e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit si dhe mundësitë e punësimit. Këto informacione u vihen në dispozicion të interesuarve nga Zyra e Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe janë të publikuara online në faqen Web. Monitorimi i burimeve të ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënësve është bërë rregullisht nga NJSBC-ja. Biblioteka është në element që duhet plotësuar dhe përmirësuar brenda institucionit.

10. Aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit**Pjesa përshkrimore**

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Referuar RVB: Kolegji Profesional i Tiranës organizon aktivitete për stafin akademik dhe për studentët në funksion të programit të studimit. KPT synon dhe investon të sigurojë një ambient sa më miqësor, të shëndetshëm dhe bashkëpunuese me studentët, dhe duke nxituar zhvillimin e aktiviteteteve të ndryshme ku studentët kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të shprehen, si dhe të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. KPT ka iniciuar krijimin e klubeve studentore, duke nisur me Klubin e Inovacionit - një klub që bashkon studentët në takime e orë të hapura për implemtimin në praktikë të të rejave më të fundit të teknologjisë, aplikimin dhe nxitjen e projekteve innovative; KPT nxit dhe favorizon pjesëmarrjen në aktivitete të organizuara nga palë të treta të cilat përkojnë me fushat e veprimtarisë së programeve të studimit në KPT. KPT i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pjesëmarrje në panairë ku studentët ndajnë përvojën e tyre apo demostrojnë aftësitë e fituara nëpërmjet paisjeve të ndryshme laboratorike. Gjithashtu, programi i studimit “Teknologji ndërtimi” pranë KPT i ka kushtuar një rëndësi të veçantë aktiviteteve profesionale në funksion të programit të studimit edhe për stafin akademik.

Bazuar në RVB dhe nga vizita pranë IAL, GVJ konstaton se programi i studimit “Teknologji ndërtimi” aktivitetet e tij i ka të fokusuar në vizita pranë laboratoreve inxhnierike dhe vizita në kantjere. Praktika profesionale është një element thelbësor i aktivitetit profesional të këtij programi dhe ai vlerçohet në fund të tij me notë dhe me kredit. Përveç studentëve, edhe stafi përfiton nga trajnimi që kompanitë që ofrojnë pajisje laboratorike ofrojnë.

11. Bashkëpunimi kombëtar (dhe ndërkombëtar)

Pjesa përshkrimore

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar (dhe ndërkombëtar) (Shih Tabelën 16 në aneks, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Referuar RVB: Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale me bizneset në vend, ku studentët krahas praktikës, të mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes /familiarizimit për t’u integruar lehtësisht në tregun e punës.

Këto marrëveshje bashkëpunimi bëjnë të mundur jo vetëm realizimin dhe plotësimin në kuadrin mësimor, por për afron gjithnjë e më shumë studentin me tregun e punës.

Marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura midis Kolegjit Profesional të Tiranës dhe Subjekteve të ndryshme pritëse lidhen për një afat të pacaktuar kohor. Përvec aspektit didaktik, një fokus shumë të veçant zë edhe punësimi i studentëve pranë këtyre kompanive.

Një vënd të rëndësishëm zënë edhe bashkëpunimet ndërkombëtare që KPT ka. Këtu mund të përmëndim bashkëpunimin me universitete dhe biznese në rajon dhe më gjerë. Duhet theksuar që këto marrëveshje akoma nuk i kanë dhënë frytet e tyre në programe e studimit “Teknologji ndërtimi”, por në një të ardhme pritët që këto bashkëpunime të japin kontributin e tyre në forcimin e mëtejshëm të programit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. PhD Egla Luca
2. PhD Erion Luga

ANALIZA SWOT

Analiza përmbledhëse sipas metodës SWOT (Strengths, Weaknesses-, Opportunities, Threats).

a. Pika të forta:

- KPT për herë të parë në vend krijoi një IAL të dedikuar arsimit profesional. Kjo e bën atë të parin në treg dhe një nga më të kërkuarit.
- Personel i kualifikuar si në nivel titujsh akademik ashtu edhe në nivel eksperience praktike, e bëjnë KPT dhe programin e studimit "Teknologji ndërtimi" shumë atraktiv në treg.
- Zhvillimi i procesit akademik dhe kërkimor në mjedise shumë miqërore dhe stimuluese si për studentët ashtu edhe për stafin. Ekzistenca e laboratoreve të cilët mbështesin procesin mësimor.
- Bashkëpunimet e shumta që KPT ka me tregun e punës dhe me partnere ndërkombëtar, ju japin mundësi stafit dhe studentëve të zhvillohen më tej dhe të mësojnë nga këto eksperiencia.
- Struktura, përmbajtja e kurrikulës dhe programet lëndore/modulare janë në përputhje me kriteret e përgjithshme shtetërore për këto programe, me modele analoge të vendeve europiane të kontekstualizuara në mjedisin dhe kërkesat globale e lokale të tregut të punës;

b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):

- Imazhi që IAL private kanë në tregun arsimor shqiptar i bën ato pak konkurrese në treg.
- Vitet e pakta të programit, e bën atë jo shumë të njohur në tregun aktual të sistemit të arsimit. Gjithashtu, vitet e pakta të programit bëjnë që ai të mos jetë i mirë konsoliduar.
- Pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës e cila aktualisht është shumë e limituar në tituj dhe botime.
- Mungesa e projekteve ndërkombëtare dhe implementimi i tyre në KPT.

c. Mundësitë:

- Pas mbarimit të këtij programi studimi, studentët mund të punësohen si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.
- Mundësi shkëmbimi pranë institucioneve partnere qoftë për studentët qoftë për stafin.
- Kryerja paralelisht e teorisë dhe praktikës ju jep mundësi studentëve të përballen që në shkollë me punën reale në teren. Praktika profesionale është një mundësi reale për punësimin e studentëve.
- Ky program studimi të jep mundësinë e transferimit të studimeve në një program tjetër profesional apo në programe bachelor.
- Mbështetja për stafin për rritjen profesionale.

d. Pengesat:

- Kriza financiare ka ndikuar në uljen e burimeve financiare në shoqërinë Shqiptare e për rrjedhojë ndihet një ulje e numrit të studentëve në arsimin universitar privat.
- Rritja e konkurrencës globale, rajonale e lokale në fushën e arsimit të lartë shpesh herë kthehet në pengesë. Kjo konkurrencë jo gjithmonë është e ndershme dhe shpesh herë i vë institucionet serioze përballë kushteve jo të favorshme.
- Në planin afatmesëm dhe afatgjatë, statistikisht ndër vite po tregojnë për një numër në ulje të maturantëve në Maturën Shtetërore.

- Mungesa e kulturës lidhur me arsimin profesional, shesh herë i bën ata më pak të dëshiruar krahasimisht me programet bachelor.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

3. PhD Egla Luca
4. PhD Erion Luga